



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 06/08**

**Prishtinë, më 27.05.2008, ora 13:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e  
Komuniteteve dhe Kthim

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Bojan Stojanović, Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Sadik Idriz, Kosara Nikolić, Numan Balić, Hafize Hajdini, Hetem Arifi, Zylfi Merxha, Mursejl Haljilji, Enis Kervan, Xhevdet Neziraj, Zafir Berisha.**

I ftuar: z. Kim Vetting, Menaxher i Programit Portofoli për Kthim, UNDP

Gjithashtu të pranishëm ishin: monitruues nga Zyra e Presidentit, UNDP, OSCE.

Nga shërbimi i sekretarisë: Natasha Tisma-Prica, Arta Hajra, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

**Kryesues: Bojan Stojanović, kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Prezantimi i programit ‘SPARK Plus’ i UNDP-së për kthim të komuniteteve.**  
I ftuar:  
z. Kim Vetting, Menaxher i Programit Portofoli për Kthim, UNDP;
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin e komisionit funksional – Komisioni**

për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente;

5. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 03/0114/, L-020/1 për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente;
7. Shqyrtimi i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shërbime publike, Administratë lokale dhe Media, me amendamente;
8. Marrëveshje lidhur me organizimin e tryezës së rrumbullakët me temën për kthim të komuniteteve dhe decentralizim;
9. Të ndryshme.

**Kryetari** hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe të ftuarin. Propozoi që pika e gjashtë dhe shtatë e rendit të ditës të shtyhet për në mbledhjen e ardhshme, për shkak se nuk është dërguar materiali në gjuhën serbe. Po ashtu materialin lidhur me një raport të komisionit funksional për një Projektligj, që është pranuar sot, të shtyhet për shqyrtim në mbledhjen e radhës.

Rendi i ditës u miratua me propozimet e kryetarit.

## **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

Procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 9.05.2008, u miratua pa vërejtje.

## **3. Prezantimi i programit ‘SPARK Plus’ i UNDP-së për kthim të komuniteteve**

**I ftuar:**

**z. Kim Vetting, Menaxher i Programit Portofoli për Kthim, UNDP**

**Kryetari** falënderoi përfaqësuesin e UNDP-së i cili i është përgjigjur ftesës për prezantimin e programit për kthimin e të gjithë komuniteteve dhe kërkoi nga ai të flas lidhur me këtë projekt.

**Kim Vetting** theksoi se programit ‘SPARK Plus’ i UNDP-së, ka për qëllim ofrimin e asistencës për kthim të qëndrueshëm të minoriteteve në Kosovë. Programi implementohet bashkërisht me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe financohet nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria Britanike. Përmes projektit dhe fondeve ekzistuese veprimtaria jonë do të jetë e koncentruar në komunën e Pejës, Istogut, Gjilanit dhe Fushë Kosovës. Asistencë pranojnë të gjithë ata individ dhe familje që pas prezantimit të dokumenteve argumentohet se janë zhvendosur nga lufta dhe dëshirojnë të kthehen në shtëpitë e tyre të shkatërruara apo demoluara. Projektet tona realizohen në bashkëpunim me komunat përkatëse dhe qëllimi ynë në të ardhmen është të barten kompetencat në Ministrinë për Kthim dhe në bashkëpunim me komunat, të realizojnë projektet e ngjashme. Sigurisht në këtë drejtim qasje duhet të kyçet edhe Komisioni juaj, sidomos të ketë qasje në mënyrën e realizimit të projekteve dhe në menaxhimin e fondeve lidhur me kthimin.

**Sanije Aliaj** pyeti se projektet e UNDP-së, a janë vetëm të orientuara vetëm për kthim të atyre që atyre që janë zhvendosur jashtë vendit apo edhe për ata që jetojnë brenda vendit, të cilët pa dëshirën e tyre janë larguar nga shtëpitë dhe pronat e tyre. Përmendi rastin në Mitrovicë ku shumica shqiptare janë zhvendosur nga Veriu për në Jug dhe nuk kanë përkrahjen e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, po ashtu përmendi edhe rastin e Kolonisë së Komunës së Gjakovës, ku njerëzit jetojnë në kushte të vështira dhe deri më tani asnjë hap nuk është ndërmarrë.

**Enis Kervan** theksoi se kur është fjala për të kthyerit, në kuadër të projekteve të përfshihen të gjitha kategoritë e komuniteteve. Përmendi të zhvendosurit e komunitetit turk nga Mitrovica Veriut që janë zhvendosur në Turqia apo edhe brenda në Prizren dhe Prishtinë, të cilët jetojnë në kushte të vështira. Pyeti a ka ndonjë projekt për këtë komunitet, për kthim në shtëpitë dhe në qytetin tyre.

**Numan Balić** bëri vërejtje rreth mospërfshirjes së të gjitha komuniteteve në projektet e UNDP-së. Si përfaqësues i komunitetit boshnjak nuk informohem se çfarë është punuar për këtë komunitet. Gjithashtu vërejtje bëri edhe sa i përket komunikimit të drejtpërdrejtë me disa persona të bashkësive duke anashkaluar komunikimin me anëtarët e këtij komisioni, që janë përfaqësues legjitim të tyre, të cilët kemi informacione të sakta për zhvendosjen dhe kthimin e tyre. Ekziston një numër i madh i të pakthyerve në regjionin e Pejës, Mitrovicës, Gore etj. Prandaj përfshirja e jonë në të gjitha projektet e UNDP-së dhe Ministrisë përkatëse në çështjet e kthimit dhe çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet është e domosdoshme. Si përfaqësues të komuniteteve duhet të dimë se si janë shpenzuar paratë lidhur me këto projekte sepse jemi të zgjedhur dhe i'u japim llogari këtyre njerëzve që i përfaqësojmë.

**Xhevdet Neziraj** theksoi se shumë të dhëna që janë paraqitur në lista nëpër komuna për kthimin e të zhvendosurve, nuk përkojnë me realitetin. Z. Neziraj theksoi se ka punuar në Drejtorinë për Marrëdhënie Etnike në Pejë dhe e njeh mirë punën që ka bërë UNDP-ja në këtë regjion. Nga informacionet që ekzistojnë, në këtë regjion nuk kemi shumë të kthyer, rasti boshnjakëve të cilët më shumë kanë ikur se sa janë kthyer. Shprehu gatishmërinë për të qenë në disponim për të ofruar informacione se ku dhe kujt duhet ndihmuar. Kërkoj që në projektet prioritare strategjike për komunitetet për të cilat vendos Ministria përkatëse të kyçen anëtarët e komisionit, sepse më së miri dhe më së afërmi njohin problemet lidhur me komunitetet që i përfaqësojnë. Duke ditur faktin se në këtë komision përfaqësohen të gjitha komunitetet atëherë është mekanizmi i cili duhet involvohet në këto procese dhe të dijë se si po shfrytëzohen mjetet e taksapaguesve kosovar dhe ato të orientohen atje ku ka nevojë më së shumti. Në këtë mënyrë do të jemi më të suksesshëm.

**Kryetari** kërkoj nga anëtarët që të bëjnë pyetje konkrete që kanë të bëjnë më pikën e rendit të ditës. U pajtua me mendimin se çështja e kthimit nuk funksionon si duhet, duhet të kthehen pasuritë të të zhvendosurve dhe të zgjidhen problemet që kanë të bëjnë me të gjithë komunitetet, pa analizuar shkaqet. Për këtë qëllim theksoi se ka planifikuar të organizohet një tryezë e rrumbullakët, ku do të ftohen institucionet vendore dhe ndërkombëtare kompetente dhe do të diskutohen këto probleme.

**Müfera Şinik** u pajtua me kolegun z. Kervan se duhet ndihmuar minoritetin turk për kthim në shtëpitë e tyre. Kërkoj që komisionit t'iu mundësohet kyçja në mbikëqyerjen e realizimit të projekteve në ato komuna që u përmenden. Bëri vërejtje broshurave të shpërndara ku është shkruar fjala “minoritete” dhe theksoi se do të duhej të jetë “komunitete”.

**Zylfi Merxha** bëri vërejtje se komunitetet romë nuk i'u është ndërtuar asnjë shtëpi. Kërkoj që aktiviteti i UNDP-së të përfshihet në më shumë se katër komuna. Vërejtje bëri edhe sa i përket Kolovicës për të cilën asgjë nuk është ndërmarrë. Në takimet që zhvillon UNDP-ja me Ministrinë përkatëse të ftohet edhe komisioni në mënyrë që bashkërisht të punojnë për përmisimin e kushteve të të gjithë komuniteteve.

**Zafir Berisha** theksoi se ndihet keq lidhur me mënyrë e realizimit të këtyre projekteve. Kërkoj që projektet e implementuara nga UNDP-ja apo edhe ndonjë organizatë tjetër, të orientohen jo vetëm në ndërtimin e shtëpive dhe zgjidhjen e problemeve individuale, por në kthim të qëndrueshëm. Në këtë kontekst komisioni duhet luajtur rolin e tij aktiv duke ofruar informata për gjendjen e secilit komunitet.

**Hetem Arifi** u pajtua me problemet që u cekën këtu. Theksoi se përfaqësuesit që punojnë në kuvendet komunale kanë pak informacione rreth gjendjes së komuniteteve dhe kthimit të tyre. Kërkoj që

paraprakisht, para realizimit të çdo projekti të konsultohen përfaqësuesit e këtij komisioni që realizohen, sepse mund të ofrojnë të dhëna më të sakta se kush duhet përfitoj. Kërkohej një bashkëpunim i të gjithëve për suksese të përbashkëta.

**Numan Balić** theksoi se listat ekzistuese nuk tregojnë një kthim real të zhvendosurve, shumica e të dhënave që figurojnë aty janë të falsifikuara, njerëzit e lajmëruar si refugjat të luftës, kanë falsifikuar kartelat, vetë e vetëm që të përfitojnë. Informatat që posedojmë, tregojnë se shumica e atyre njerëzve të paraqitur kanë ikur nga Kosova para lufte. Prandaj kjo tregon se nuk duhet biseduar me individ, por paraprakisht të konsultohen përfaqësuesit e tyre, anëtarët e këtij komisioni që mund të ofrojnë të dhëna më të sakta. Duhet një bashkëpunim i përbashkët, është koha e fundit për të ndërmarrë diçka në këtë drejtim.

**Sanije Aliaj** theksoi se e shqetëson fakti i mungesës së të dhënave për kthim të minoriteteve. Kërkoj që bashkëpunimi në mes Qeverisë (Ministrive përkatëse), Komisionit, UNDP-së dhe Kuvendeve Komunale të jetë i duhur, në përcaktimin e prioritetëve për realizimin e projekteve në mënyrë të duhur dhe në trajtim të barabartë për të gjithë komunitete që jetojnë në Kosovë.

**Sadik Idriz** lidhur me diskutimet, kërkoj që të orientohen në pyetje konkret dhe të shkurtra, ndërsa për problemet e komuniteteve dhe kthimin e tyre të organizohet një takim i veçantë.

**Kim Vetting** lidhur me pyetjet e diskutuesve shpjegoi se UNDP-ja realizon projektet në ndihmë të të gjithë komuniteteve që janë zhvendosur nga lufta, të tjerat raste janë jashtë projektit. Lidhur me zhvendosjen e komunitetit turk nuk kemi shumë të dhëna por jemi të gatshëm të fusim në projekt posa të marrim informacionet e duhura lidhur me situatën e tyre. Z.Vetting theksoi se roli i komisionit në çështjet e kthimit që janë të orientuara edhe projektet tona është crucial. Përfaqësuesit e këtij komisioni duhet ofruar informata më të sakta për numrin e të zhvendosurve, për kategorizimin e prioritetëve të rasteve me qëllim të realizimit të projekteve për një kthim të qëndrueshëm. Komisioni duhet mendoj edhe për rregullimin më të mirë të kornizës ligjore për kthimin. Bashkëpunimi në mes institucioneve kompetente që u përmenden është nevojë e domosdoshme për një punë të suksesshme. Përkrah idenë e organizimit të tryezës së rrumbullakët për të diskutuar për këto çështje dhe është theksoi se është në dispozicion të komisionit për të ofruar informacione që janë në interes të të gjithëve.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente**

**Kryetari** kërkoj nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë dhe shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-5 për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin e komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport e Telekomunikacion, me amendamente dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se amendamentet e propozuara nuk

cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, ta miratojë atë.

## **5. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente**

**Sanije Aliaj** kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara nëse mendojnë se ato cenojnë dhe shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **R E K O M A N D I M**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.
- II. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi raportin komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente, dhe të njëjtin e përkrahu me konstatimin se amendamentet e propozuara nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit që në procedurë të mëtejme, të miratojë atë.

## **6. Marrëveshje lidhur me organizimin e tryezës së rrumbullakët me temën për kthim të komuniteteve dhe decentralizim**

**Kryetari** njoftoi anëtarët që së bashku me OSBE-në do të organizohet një tryezë e rrumbullakët ku do të diskutohet për çështjen e kthimit dhe decentralizimin. Do të ftohen institucionet si: (Ministria për Kthim, Ministria për Pushtet Lokal, Ministria për Punë dhe Mirëqeni e Sociale), si dhe institucionet dhe organizatat kompetente vendore dhe ndërkombëtare që kanë të bëjnë me çështjet e komuniteteve.

**Numan Balić** u pajtua me propozimet e kryetarit, kërkoi që të pranishëm të jenë edhe nga Kryesia Kuvendit, nga Kabineti i Rykerit dhe kjo tryezë të organizohet para 15 qershorit.

**Sanije Aliaj** u pajtua me propozimet e parafolësve, por kërkoi që paraprakisht të marrin informacione për temat që do të diskutohen që të jemi më konstruktiv dhe më konkret.

**Xhevdet Neziraj** lidhur me këtë kërkoi që të organizohet tryeza sa më shpejt të jetë e mundur, të ftohen institucionet kompetente dhe komisioni në fund të nxjerr rekomandimet nga ky takim.

**Enis Kervan** propozoi që të organizohen dy tryeza të tilla, në njërën do të duhej të diskutohet për kthimin, kurse në tjetrën për decentralizimin sepse janë dy tema të ndara. Përveç institucioneve që u përmenden të ftohet edhe përfaqësuesit e UNMIK-ut.

**Kryetari** përkrahu propozimet e anëtarëve që tryeza të organizohet para 15 qershorit, do të ftohen të gjitha institucionet kompetente. Komisioni në fund të takimit do të përgatit raport me rekomandime i cili do të pasqyroj diskutimet dhe vendimet nga ai takim. Në vazhdim kërkoi nga anëtarët të deklarohen se për cilën temë të diskutohet në tryezën e parë: për kthimin apo për decentralizimin.

Pas sqarimeve dhe propozimeve të dhëna, me votimin e bërë Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **K O N K L U Z I O N**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim vendosi që në bashkëpunim me OSBE të organizojë dy tryeza të rumbullakëta. Në tryezën e parë, temë e diskutimi do të jetë: kthimi, ndërsa në tryezën e dytë temë diskutimi do të jetë: decentralizimi.
- II. Komisioni vendosi që në të dy këto tryeza të rumbullakëta, të ftohen institucionet dhe organizatat kompetente vendore dhe ndërkombëtare që të raportojnë për punën e tyre lidhur me këto tema.

Mbledhja përfundoi në ora 15:15

Shërbimi i komisioneve

**Kryetari i Komisionit**

**Bojan STOJANOVIĆ**

